

VENDIM
Nr.418, datë 2.7.2004

PËR MASËN E PËRDORIMIT TË TË ARDHURAVE NGA PRIVATIZIMI I SHOQËRISË ANONIME “ALBTELECOM”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8810, datë 17.5.2001 “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime “Albtelecom”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe të Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Masa e përdorimit të të ardhurave nga privatizimi i shoqërive anonime “Albtelecom”, të jetë si më poshtë vijon:

a) Për mbulimin nga Ministria e Ekonomisë të shpenzimeve për realizimin e shitjes së aksioneve dhe për pagesën e tarifës së suksesit shoqërisë këshilluese, sipas kontratës së lidhur me të, deri në 10 për qind.

b) Për mbulimin e fondeve për trajtimin e punonjësve, që do të dalin të papunë nga procesi i ristrukturimit, sipas vendimit nr.495, datë 14.8.2001 të Këshillit të Ministrave.

c) Pjesa e mbetur të derdhet në Buxhetin e Shtetit.

2. Struktura e këtyre pagesave të parashikohet në ligjin për Buxhetin e Shtetit, për vitin pasardhës.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit të paraqesin, pas përfundimit të procesit të shitjes, raportin financiar për përdorimin e vlerave të mësipërme.

4. Ngarkohen Ministri i Ekonomisë, Ministri i Transportit dhe i Telekomunikacionit dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano